



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 598/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje individuale të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Besim A. Zejnullahu B.I. – N.SH.Eko-DDD” - Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Vlera SH.P.K” Shtime, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore”, me nr. të prok: 616-20-3417-2-22-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë, më datë: 25.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Besim A. Zejnullahu B.I. – N.SH.Eko-DDD” - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore”, me nr. të prok: 616-20-3417-2-22-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore”, me nr. të prok: 616-20-3417-2-22-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Besim A. Zejnullahu B.I. – N.SH. Eko-DDD” - Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Besim A. Zejnullahu B.I. – N.SH.Eko-DDD” - Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.08.2020 me nr. 598/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore”, me nr. të prok: 616-20-3417-2-22-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 28, 56, 59, 69, 72 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 10.09.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi i parë ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, OE ankues e konteston kontratën mes OE të rekomanduar për kontratë dhe z.Miftar Elshani – Epidemiolog. OE ankues në ankesë thotë se kontrata është nënshkruar 02.03.2020 me afat deri më datë 01.03.2020, mirëpo se në brendi të kontratës shënon se i punësuar themelon marrëdhënie pune për kohë të caktuar nga 02.03.2020. Po ashtu, OE ankues pretendon se në kontratë nuk është shënuar numri personal i z. Elshani. Konsiderojmë se sa i përket datës 02.03.2018, kjo mund të jetë gabim teknik gjatë përpilimit të kontratës, megjithatë rekomandojmë që AK-KK Prishtinë të verifikojë edhe një herë vërtetësinë e kësaj kontrate përmes punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe numrin personal të z. Elshani.

Pretendimi i dytë ankimor është se OE i rekomanduar për kontratë, lidhur e pajisjet e kërkuara ka ofruar fatura fiktive. Duhet të theksojmë se eksperti shqyrtues nuk ka kompetencë e as kapacitet teknik/profesional për të dhënë përgjigje në këtë pretendim ankimor. Me gjithë këtë vlerësojmë që me rastin e rivlerësimit të ofertave të obligohet AK – KK Prishtinë të bëjë verifikimin e ATK-së për vërtetësinë e faturave të kontestuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore për kontratat/referencat e OE të rekomanduar për kontratë, vlerësojmë se kontrata/referenca me KK Vushtrri është e papranueshme sepse e njëjta kontratë përfundon në vitin 2022 dhe nuk mund të merret si “kontratë e realizuar” siç është kërkesa në dosje të tenderit.

Sa i përket kontratave me “Viva Fresh”, OE pretendon se ato janë të dyshimta dhe se kontrata me spitalin “Sirona” është e manipuluar, mirëpo edhe në këtë rast duhet të theksojmë se eksperti shqyrtues nuk ka kompetencë e as kapacitet teknik/profesional për të dhënë përgjigje në këtë pretendim ankimor, dhe në rast të kthimit të lëndës në rivlerësim, i rekomandojmë Panelit Shqyrtues të obligojë AK – KK Prishtinë të bëjë verifikimin e këtyre faturave përmes ATK-së. Bazuar në te gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimet ankimore të OE ankues janë pjesërisht të bazuara.

Më datë 15.06.2020, eksperti shqyrtues ka dërguar një plotësim ekspertize, në të cilën sqaron si në vijim:

Më datë 10.09.2020 kam dorëzuar raportin e ekspertizës 598/20, ku kam rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim të verifikimit të disa dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë. Më konkretisht, kemi rekomanduar të bëhet verifikimi i kontratës me epidemiologun, verifikimi i faturave për pajisje dhe verifikimi i disa kontratave që gjenden në liste të OE të rekomanduar për kontratë.

Më 09.09.2020 OE i rekomanduar për kontratë ka dërguar disa sqarime në OSHP të cilat unë si ekspert shqyrtues nuk i kam parë deri pas dorëzimit të raportit të ekspertizës. Pas shikimit dhe analizimit të sqarimeve të dërguara nga OE i rekomanduar për kontratë, kemi gjetur se i njëjti ka dërguar dëshmitë nga banka për pagesat e bëra lidhur me faturat e pajisjeve, si dhe dëshmitë nga banka për pagesa për kontratat e kontestuar nga OE ankues.

Ndërsa më datë 11.09.2020, OE ankues duke u përgjigjur në raportin e ekspertizës, ndër të tjera thekson se OE i rekomanduar për kontrate ka intervenuar në dokumentin MSDS nr. 100057, duke i shtuar mbishkrimin Certificates of Analysis. Duhet theksuar se kjo ka qenë pretendim ankimor edhe në ankesën nr. 598/20, ndërsa në përgjigje në ekspertizë, OE ankues si dëshmi ka ofruar një kopje të dokumentit që gjendet në ofertë të OE fitues, dhe një kopje të shkarkuar nga interneti.

Pas analizimit dhe krahasimit të këtyre dy dokumenteve, vlerësojmë se të gjitha të dhënat janë identike, me përjashtim se dokumenti i gjetur në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë mban edhe mbishkrimin "Certificates of Analysis". Pas hulumtimit të mëtutjeshëm në internet, kemi mësuar se dokumentet MSDS dhe Certificate of Analysis, janë dy dokumente të ndryshme që dallojnë nga njëra tjetra, dhe është e paqartë se si mundën të dy emërtimet të gjenden në të njëjtin dokument, siç është në rastin konkret dokumenti në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë.

Në fund shtojmë se mbesim pranë rekomandimit që lënda të kthehet në rivlerësim, ndërsa arsyeja për rivlerësim është verifikimi i kontratës me epidemiologun, dhe në veçanti verifikimi i dokumentit

MSDS.No.100057 i dates 15 Prill 2007.

Sa i përket pretendimeve ankimore rreth faturave të pajisjeve dhe kontratave të kontestuara nga OE ankues, vlerësojmë se sqarimet/dëshmitë e pagesave nga banka në mënyrë objektive dëshmojnë realizimin e atyre kontratave/faturave. Për më tutje, i mbetet Paneli Shqyrtues nëse e sheh të arsyeshme të bëhet verifikim i mëtutjeshëm i këtyre dokumenteve përmes ATK-së ashtu siç ka kërkuar OE ankues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet, lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 11.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke sqaruar si në vijim:

Fillimisht e çmojë punën e juaj si ekspert që keni bërë hulumtime sërish për pretendimet tona vetëm që të jeni të saktë në raportin e ekspertizës. Duke u bazuar në hulumtimet tona deri në dërgim të Ankesës në OSHP nuk kemi pasur asnjë dëshmi pagese për këto pajisje, e nëse OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë dëshmi pagese nga banka pas kësaj date dhe pas kërkesës që kemi bërë në standardet e ATK-së, është si rrjedhojë se ATK ka filluar me procesimin e rastit dhe si duket aty ka rrjedhë diçka. Vet fakti se Furnitori i tij për këto pajisje "NTP DEA" ka lëshuar faturë me nr. 11 në muajin Gusht 2020, ndërsa numrat e faturave për pajisje janë 113 dhe 325 të lëshuara në muajin Shkurt dhe Prill 2020 shihet haptas për parregullsi. Ne mund të japim supozimet tona, por për t'u informuar saktë dhe për të marrë një vendim të drejtë, Paneli Shqyrtues mund të kërkojë sqarime nga ATK ku e njëjta ka deklaruar se mund të ndaj informacione vetëm me organet kompetente dhe institucionale e në këtë rast me OSHP-në nëse e bën një kërkesë të tillë. Që të jemi sa më transparent dëshmitë që keni pranuar mund të ndani me Ne dhe Panelin Shqyrtues, pasi që për të gjitha kontratat e shprehura në vlerë Euro që janë të shënuara në Listën e kontratave, nuk mund të jenë të realizuara pasi që shumica prej tyre janë ende në proces. Në ekspertizën e dërguar nga ana e juaj me datë 10.09.2020, keni deklaruar se KK Vushtri është e pa pranueshme sepse përfundon në vitin 2022 dhe nuk mund të merret si "kontratë e realizuar" siç është kërkuar në dosje. E njëjta duhet të vlejë edhe për kontratën me Kompaninë Rajonale e Ujësjellësit Prishtina në vlerë prej 9,817.60 Euro (e nënshkruar 10.07.2019, sipas kontratës skadon 2 vite pas nënshkrimit) edhe për kontratën me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në vlerë prej 9,440 Euro (nënshkruar 16.10.2019, neni 1 i kontratës i pa skanuar nga OE për shkak të datës së skadimit pasi që kjo kontratë është për 2 vite). Për VIVA Fresh duhet saktë të ketë një vlerë të realizuar dhe

të dëshmuar për 3 vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë (06.07.2020) përndryshe në bazë të listës nuk mund të pranohen vlerat e cekura, pasi që edhe vet Viva Fresh në referencat e lëshuara nuk e ka dëshmuar të njëjtën. Po ashtu, viti 2016 dhe gjysma e vitit 2017 nuk mund të llogariten pasi që janë më shumë se tri vite nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Mos të harrohen se gjatë verifikimit të kontratës me epidemiologun të kërkohen sqarime se si është e mundur të përpilohet një kontratë me 02.03.2018 me një epidemiolog pa numër personal dhe e shënon se ka krijuar marrëdhënie pune prej datës 02.03.2018, ndërsa data e përpilimit 02.03.2020 dhe e njëjta të nënshkruhet nga të dy palët! Në bazë të dhënave të ofruara nga OE në CV të epidemiologut thotë se I njëjti punon te OE VLERA SHPK prej 02.03.2018 dhe vazhdon, e krejt kjo mund të kryhet me një dokument të vetëm që lëshohet nga Trust-i, andaj kërkojmë nga ana e juaj që kjo t'i potencohet AK Komuna e Prishtinës ta kërkojë pasi që e njëjta mund t'a anashkaloj si në vlerësimin e parë. Ne sërish habitemi pse Eksperti nuk ka përmend fare pretendimin nr. 5 për Specifikimet teknike të detyrueshme për të cilat OE "VLERA" SHPK nuk ka ofruar dokumentet e kërkuara sipas dosjes për asnjë produkt të vetëm. Në bazë të Dosjes së tenderit SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME për produktet të cilat kërkohen, janë gjetur se mungojnë dokumentet për të gjitha produktet si në vijim:

Te Deratizmi për Rodenticidet mungon Certifikata e A-testit (analizave), ndërsa për pllakat e minjve mungon Certifikata e analizave dhe Leja nga MMPH.

Te produktet për Dezinsektim dhe Dezinfektim nuk ka ofruar certifikate A-testit (analizave) për asnjë produkt të vetëm të kërkuar sipas dosjes.

Të gjitha në detaje janë të cekura nga ana e jonë në Ankesën e dërguar në AK Komuna e Prishtinës dhe në Ankesën e dërguar në OSHP me datën 26.08.2020 .

Ne shpresojmë që Paneli i OSHP-së të bëjë një vlerësim të drejtë dhe të kthejë lëndën në rivlerësim dhe të kërkojë nga AK Komuna e Prishtinës që në detaje të kërkohen të gjitha dëshmitë dhe dokumentet që janë kërkuar në bazë të Dosjes së Tenderit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, i cili konteston kontratën me OE të rekomanduar për kontratë dhe z.Miftar Elshani – Epidemiolog. OE ankues në ankesë thotë se kontrata është nënshkruar 02.03.2020 me afat deri më datë 01.03.2021, mirëpo se në brendi të kontratës shënon se i punësuari themelon marrëdhënie pune për kohë të caktuar nga 02.03.2020. Po ashtu, OE ankues pretendon se në kontratë nuk është shënuar numri personal i z. Elshani.

Paneli shqyrtues pasi që analizoj pretendimin ankimor vlerëson se sa i përket datës 02.03.2018, mund të jetë gabim teknik gjatë përpilimit të kontratës, megjithatë AK-KK Prishtinë obligohet që gjatë rivlerësimit të verifikojë edhe një herë vërtetësinë e kësaj kontrate përmes punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe numrin personal të z. Elshani.

Pretendimi i dytë ankimor është se OE i rekomanduar për kontratë, lidhur e pajisjet e kërkuara ka ofruar fatura fiktive. Paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë më 09.09.2020 OE i rekomanduar për kontratë ka dërguar disa sqarime në OSHP më saktësisht OE ka dërguar dëshmitë nga banka për pagesat e bëra lidhur me faturat e pajisjeve, si dhe dëshmitë nga banka për pagesa për kontratat e kontestuar nga OE ankues që në mënyrë objektive dëshmojnë realizimin e atyre kontratave/faturave, por AK gjatë rivlerësimit mund të bëjë verifikimin e mëtutjeshëm të këtyre dokumenteve përmes ATK-së ashtu siç ka kërkuar OE ankues.

Sa i përket pretendimeve ankimore për kontratat/referencat e OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se kontrata/referenca me KK Vushtrri është e papranueshme sepse e njëjta kontratë përfundon në vitin 2022 dhe nuk mund të merret si “kontratë e realizuar” siç është kërkesa në dosje të tenderit.

Ndërkaq sa i përket kontratave me “Viva Fresh”, OE pretendon se ato janë të dyshimta dhe se kontrata me spitalin “Sirona” është e manipuluar, dhe këto dyshime të OE ankues paneli shqyrtues nuk ka kompetencë ti vërtetoj, mirëpo AK gjatë rivlerësimit të bëjë verifikimin e këtyre faturave përmes ATK-së.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues pas pranimi të raportit të ekspertizës është përgjigjur me datën 11.09.2020, ku ndër të tjera thekson se OE i rekomanduar për kontrate ka intervenuar në dokumentin MSDS nr. 100057, duke i shtuar mbishkrimin Certificates of Analysis. OE ankues si dëshmi ka ofruar një kopje të dokumentit që gjendet në ofertë të OE fitues, dhe një kopje të shkarkuar nga interneti e që këtë pretendim e

ka cekur edhe në ankesë.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit dhe krahasimit të këtyre dy dokumenteve, vërehet se të dhënat janë identike, me përjashtim se dokumenti i gjetur në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë mban edhe mbishkrimin "Certificates of Analysis". Nëse hulumtohet në internet, vërehet se dokumentet MSDS dhe Certificate of Analysis, janë dy dokumente të ndryshme që dallojnë nga njëra tjetra, dhe është e paqartë se si mundën të dy emërtimet të gjenden në të njëjtin dokument, siç është në rastin konkret dokumenti në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë. Andaj, duke u bazuar në sqarimin e dhënë si më lartë paneli shqyrtues sqaron se AK KK Prishtinë obligohet që gjatë rivlerësimit të bëjë verifikimin e dokumentit MSDS.No.100057 të datës 15 Prill 2007.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së pasi që nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform kësaj dispozite ligjore. Paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë rivlerësimit duhet të bëjë verifikimin të çështjeve kontestuese sipas konstatimeve të dhëna si më lartë nga paneli shqyrtues.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK duhet të ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është që në mënyrë efikase dhe transparente të sigurojë të drejtën e shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Prishtinë

1x1 OE -"Besim A. Zejnullahu B.I. – N.SH.Eko-DDD" - Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI